

**EVALDA PACI****AT MARIN SIRDANI O.F.M. DHE STUDIMET  
MBI SKËNDERBEUN\***

**Na e dijmë, se nder malet t'ona, per nji burrë të tepruem, per nji div a kreshnik, thonë se lë drangue. Nji nieri këso dore e falë Zot'ynë të pështjellun me nji pelhurë të hollë, si shark bolle, me fletë nën sjetulla, e i ep nji fuqi të mbinatyrëshme. Kështu, mbas gojëdhânash, u lë edhe Skanderbegu.<sup>1</sup>**

Emri i at Marin Sirdanit O.F.M., meshtarit që iu kushtua plotësisht gjurmimeve në fushë të historiografisë shqiptare dhe evidentimit të burimeve më të përshtatshme që mund të shërbenin për të rindërtuar periudha e jetë personalitetesh të rëndësishme për historinë e kombit tonë, lidhet pazgjydhshëm dhe me kërkimet mbi jetën e bëmat e heroit tonë kombëtar, emri i të cilit spikat në tituj punimesh dhe në trajtesa shkencore që ky i fundit ka përpiluar në dekadat e para të shekullit të kaluar.

At Marin Sirdani O.F.M. mbetet një prej françeskanëve të mëdhenj që jetoi gjatë dhe në kujtimet e at Zef Pllumit O.F.M., ndërkohë që prodhimitaria e tij në lamijet e sipërpërmendura do të radhitet krahas emrash po aq të spikatur të historisë së urdhrimit françeskan shqiptar, të gjithë të orientuar ndaj mbrojtjes së idealit kompleks që kishte të bënte me atmen dhe me besimin, një binom që i përpiluar dhe i ekspozuar dhe në gjuhën latine (*pro aris et focis*), do të përfaqësojë kredon dhe prirjen e një plejade të tërë misionarësh dhe njerëzish të ditur të tokës shqiptare. Nuk janë aspak modeste për nga rëndësia shkrimet e thukëta, por thellësisht shkencore me të cilat dhe at Marin Sirdani O.F.M. përuroi numrat e parë dhe mjaft të rëndësishëm të së përkohshmes *Zâni i Shna Ndout*, duke u vënë përkrah me komemoracionin e shprehur në shumë forma dhe gjini shkrimi që i kushtojë një figure të rëndësishme të besimit të krishterë në

---

\* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore organizuar në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Skënderbeut, Edicioni IX i Ditëve të Albanologjisë, organizuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, më 3-5 dhjetor 2018.

<sup>1</sup> Marin Sirdani O.F.M., *Skanderbegu mbas gojëdhânash, Pjesa e parë; Kallxime tradicionare, Kaptina e parë; Luftat e Skanderbegut*, Shkodër: 1926, f. 21.

Shkodër dhe në Shqipërinë e Veriut si Zoja e Këshillit të Mirë, po ashtu dhe problematikës së interpretimit të shkrimit të shenjtë dhe liturgjisë së të dielës që ndërmerret sistematikisht në atë kohë nga i nderuemi Imzot Vinçens Prennushi O.F.M.

Qasja e at Marin Sirdanit O.F.M. ndaj elementëve themelorë të biografisë së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriotit, interesimi konkret ndaj personalitetit të një luftëtari që për nga bëmat dhe rreziqet me të cilat zgjedh të përballet meritonte të ngrihej në një pedestal të lartë nderimi e celebrimi, zbulon qartë faktin që dhe në këto sprova që në të vërtetë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kontributeve shkencore të atit tonë françeskan, ai mbetet një historian që vlerëson objektivisht dhe njeh gjithashtu burimet më të rëndësishme që orientojnë ndaj përvijimit të një historie të Skënderbeut nga pozita e hulumtuesit shkencor. Burimet që lidhen drejtpërdrejt dhe me kontekstin në të cilin jetoi dhe militoi Gjergj Kastrioti gëzojnë dhe njëfarë hierarkie vlerësimi dhe konsiderimi në shkrimet e at Marin Sirdanit O.F.M., ndërkohë që ky i fundit nuk ka munguar të vlerësojë dhe të dhënat jo të pakëta që kanë ofruar për historianin dhe rindërtuesin e një historie të tillë dhe disiplina të tjera sa konkrete dhe po aq të lidhura me humanitetin, ndër të cilët dhe arkeologjia e botës së krishterë. Personaliteti i at Marin Sirdanit O.F.M. zbulohet gradualisht nëpërmjet prurjeve të bollshme që dëshmohen nga artikuj dhe trajtesa shkencore që më së pari panë dritën e botimit në revista kulturore dhe drejtoreshin kryesisht nga Provinca Françeskane shqiptare. Ato mbeten një argument tërheqës leximi dhe për ecurinë që autori vetë ka zgjedhur të ndjekë në çdo parashtrim të vetën në faqet e këtyre revistave.

Edhe në shkrimet në të cilat personalitetit i Gjergj Kastriotit zë një vend qendror dhe është objekt motivimi për Sirdanin si autor, mund të vilen pjesë të rëndësishme që duke shërbyer si elemente parahistorike që mbështesin gjithë skenarin e shfaqjes së heroit tonë në një kontekst të ndërlikuar nga shumë pikëpamje, vlejnë gjithashtu dhe për të pasur ide të qarta mbi gjithë shtjellimet historike që nuk i munguan Ballkanit dhe viseve tona në veçanti, të përfshira në vazhdimësi në zhvillime sa politike, aq dhe të lidhura me çështje territoriale dhe autonomie. Një ide më e qartë mund të krijohet po të kihet parasysh dhe një gamë më e gjerë shkrimesh që mbajnë autorësinë e at Sirdanit O.F.M. e që në vetvete dëshmojnë interesin e vazhdueshëm që ai vetë kishte për historinë e kishës dhe të besimit të krishterë në trojet shqiptare dhe në shekujt që i

prijnë në pikëpamje kronologjike ngjarjeve dhe zhvillimeve që lidhen me Gjergj Kastriotin. Mbetet ky i fundit një element përherë i pranishëm në objektivat e tij studimore, ndërkohë që nuk mungon të shërbejë si parashtrësë dhe në shkrime specifike në pikëpamje tematike si *Në shka fajiset Skanderbegu*<sup>2</sup>; *Nji rival i Skanderbegut*<sup>3</sup> etj.

Logjika e vetë shkrimeve në fjalë presupozon të disponohen në pikëpamje burimesh mbështetëse çka ofrohet nga një dokumentacion që lidhet me mesjetën e hershme dhe me evidentimin e pranisë së mjaft familjeve princërore të dheut të Arbërit. Një fakt i tillë pasqyrohet veçanërisht në një nga shkrimet e sipërpërmendura e që ka për objekt trajtimin e një rrethimi shoqëror që ndikon konkretisht dhe në veprimtarinë e Gjergj Kastriotit. Një panoramë marrëdhëniesh dhe shkëmbimesh ndërfishnore që datojnë të paktën që nga gjysma e viteve 1300 e më tej është më se e domosdoshme nëse kihet parasysh se dhe figura e Lekë Dukagjinit nuk qe pa peshë e ndikim në të gjithë mozaikun e ngjarjeve dhe rrethanave që lidhen drejtpërdrejt me periudhën në të cilën Kastrioti figuron si protagonist i një historie të shënuar nga mjaft zhvillime dhe episode për t'u kujtuar për shekuj me radhë. Fisnikët e tokës së Arbërit do të ndërmenten jo pak herë në shkrimet e at Marin Sirdanit, ndërkohë që dhe nëpërmjet analizimit të personalitetit të tyre ai vetë do të arrijë në krahasime që kanë objekt vëmendjeje përherë figurën e Gjergj Kastriotit.

Parahistoria e një periudhe të tillë që ndërmerret si nga at Marin Sirdani, si nga Fan Noli në një kohë të afërt me të në të vërtetë përbëjnë ndihmesa të çmuara në pikëpamje të një parashtrëse historike që ndihmon të kihen ide më të qarta mbi shtjellimet jo fort të qeta që kanë përfshirë ndarjet e asaj kohe në pikëpamje administrative, por dhe të provincave kishtarë.

Në çdo trajtesë (sado të thukët) që do të ndërmerrim për të vënë në dukje kontributin e mirëfilltë shkencor të at Marin Sirdanit O.F.M. për rindërtimin e historisë së Skënderbeut, nuk mund të mos bëhet fjalë për burimet që ai ka zgjedhur të shfrytëzojë dhe t'i konsiderojë si referenca

---

<sup>2</sup> Marin Sirdani O.F.M., "Në shka fajiset Skanderbegu", në *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Shkodër: Botime Françeskane, 2017, f.42 (botuar së pari në *Hyllin e Dritës*, n.2, 1935; n.3, 1935; n.11, 1935; n.1, 1936; n.2, 1936; n.3, 1936).

<sup>3</sup> Marin Sirdani O.F.M., "Nji rival i Skanderbegut", botuar në *Hyllin e Dritës*, n.7-8, 1932, f.385-395 (pasqyruar në *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Shkodër: Botime Françeskane, 2017, f.43-65).

kryesore, sepse në njëfarë mënyre krijohen ide të qarta dhe për orientimin e tij si hulumtues dhe njëkohësisht dhe për koherencën e tij ndaj përpilimeve më të fundit e që përkojnë me kohën kur ai vetë shkruan dhe i kushtohet këtij argumenti. Vlerësimi i tij për botimin e vitit 1921 të “Historisë së Skënderbeut” nga Fan Noli do të konkretizohet jo vetëm në një shënim përkatës që vihet në parathënien me të cilën introduktohet vepra me titull *Skanderbegu mbas gojdhânash*, por dhe në notat me të cilat ai ka pajisur shkrime në të cilat bën fjalë për betejën e Torviollit apo për të tjera episode që janë themelore në historinë e jetës dhe bëmave të Heroit tonë Kombëtar. Do të vihet re fare qartë që ai vetë ka konsultuar një dokumentacion të posaçëm arkivor ndërkohë që sjell të dhëna mbi prijësit arbër që ishin përfshirë në marrëdhëniet dhe shkëmbimet me shtete të kohës, ndër të cilat dhe Venedikun. Këto të dhëna përveç se vlejné në pikëpamje të kërkimeve historike që lidhen me periudhën në fjalë, mbeten dhe burime me vlerë në lidhje me historinë e përdorimit të mbiemrave të caktuar dhe jetëgjatësinë e tyre të pasqyruar nëpërmjet një arsenali të pasur dokumentar.

Nga ana tjetër, vërehet fare qartë që shtysa për të përpiluar shkrime që kanë mbetur të papërsëritshme si nga përmbajtja, ashtu dhe nga elementët përmbajtësorë, autorit i ka ardhur nga një admirim i përmasave jashtë së zakonshmes për prijësin arbëror Gjergj Kastrioti, biografinë e të cilit Sirdani e ka gjurmuar jo pak dhe duke u munduar ta zbardhë në mjaft momente dhe episode. Nota të qarta entuziazmi për aftësitë e tij prej strategu dhe ndikimin ndaj princave të tjerë të Arbërit lexohen qartë ndërsa përshkruhet jehona e bëmave të tij mbas betejash që kanë mbetur të pashlyera në kujtesën historike të kësaj periudhe.

Marin Sirdani O.F.M. plotëson natyrshëm me kontributet e tij të shumta një mozaik sprovash të cilat duhet të kenë në radhë të parë objektivin e trajtimit në një këndvështrim realist si të vetë impostimit të një personazhi kompleks si Gjergj Kastrioti, ashtu dhe rrethanat konkrete në të cilat ai u gjind pas kthimit në vendlindje.

Gjeografia e principatave të Arbërit, interpretimi i saj nga historianë të ndryshëm, dallimi në pikëpamje roli mes Gjergj Kastriotit, paraardhësve të tij me lidhje gjaku dhe princave të tjerë të viseve arbërore përfshihet drejtpërdrejt dhe në lidhje me një argument të tillë, që nuk humbet interesin as në ditët e sotme, në pikëpamje të rikthimit të vëmendjes ndaj rindërtimit diakronik të një areali gjeopolitik që ka të bëjë me konfigurimin e vendeve në të cilat popullsitë shqiptare jetonin në

kohë të Skënderbeut. Në vështrimin e at Marin Sirdanit O.F.M. historianë dhe biografë të Gjergj Kastriotit janë parë në pikëpamje të një trajtесе të gjerë sinoptike, nën orientimin e qartë që në shtjellimet e tij të mbizotërojë objektivizmi, por dhe pozitiviteti ndaj figurës së një prijësi, trimëria e të cilit njihej që para se të kthehej përfundimisht në vendlindje, por që do të marrë ndërkohë të tjera dimensione dhe domethënie në rrethanat që do t'i duhet të mbulojë një rol aspak të lehtë dhe shumë sfidues për kohën dhe për vetë realitetin e marrëdhënieve mes principatave dhe fuqive të kohës të interesuara dhe për integritetin e fuqizimin e tyre, por dhe për ruajtjen e interesave ekonomike e tregtare, gjithashtu dhe territoriale.<sup>4</sup>

Mbiemrat dhe titujt që heroi ynë do të marrë në analet e kohës, qoftë dhe në ato të dokumentacionit venecian dëshmojnë qartë çka pritej dhe dëshirohej prej tij, ndërkohë që janë pikërisht faktet e sjella dhe nga këta historianë që dëshmojnë që Kastrioti jo rrallë u gjend i vetëm, pa ndihmat e duhura ekonomike dhe ushtarake, përballë një fuqie në rritje me të cilën ishte e qartë që në ndryshim me pozicionimin e shteteve të tjera nuk donte të kishte kompromise dhe afrime.

Përveç faktit që një interes të veçantë përbëjnë interpretimet e vetë Marin Sirdanit O.F.M. në lidhje me qëndrimet që shprehen në veprat që iu kushtuan posaçërisht këtij argumenti, gjuha që rezulton e përdorur në dokumentet që në këto shkrime janë sjellë në formë të shqipëruar të orienton natyrshëm drejt një periudhe në të cilën flitet për hierarki ofiqesh, marrëdhënie mes shtetesh dhe principatash, për pavarësi territoriale dhe për një sistem ekonomik që patjetër ka dhe regjistrin përkatës të emërtesave dhe elementeve më specifike të saj. Gjergj Kastrioti mbetet një prej figurave më të trajtuara në gjurmimet e at Marin Sirdanit O.F.M., njohës i sprovuar i një literature të gjerë faktike dhe historiografike në lidhje me këtë figurë themelore të historisë sonë kombëtare, por dhe i një arsenali të pasur gojëdhënash dhe krijimesh me burim popullor që kanë të bëjnë me të.

Në pikëpamje të interpretimeve që at Marin Sirdani O.F.M. jep ndërkohë që dhe shtjellon fakte dhe argumente që janë rimarrë dhe në vazhdë të zhvillimit të historiografisë shqiptare dhe të huaj, veçuan dhe

---

<sup>4</sup> Shih në veçanti Marin Sirdani O.F.M., "Kontributi i elementit katolik shqyptar në lamë t'atdhetaris që prej kohve të vjetra deri në kohen e Turqve të Ri", në *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Shkodër: Botime Françeskane, 2017, f.172-173 (botuar së pari në *Hyllin e Dritës*, n.7-8, 1933, f.328-351).

një mendim më të përmbledhur në lidhje me figurën dhe bëmat e Skënderbeut, të shprehur në paragrafin e mëposhtëm:

*Është e vertetë se Skanderbegu muejti ndonji herë me kursye ndonji beteje, por at e bëni për mos me kalie rasi të favorshme për me ndrydhë anmikun e perbashkët. S'ka dyshim se në Skanderbegun është për t'admirue ma fort guximi që pat me i ndëj për ball me një grusht nierz fuqis otomane për më se njëzet e kater vjet se zotsija që tregoj në mjeshtrinë e luftës, tuj dalë përherë ngadhënyes mbi anmiqt e vet, edhe pse me numer shumë më të madh.<sup>5</sup>*

Mund të konstatohet pa dyshim që dhe kur përshkruan personazhe që në pikëpamje virtytesh mund të rivalizojnë me Gjergj Kastriotin, at Marin Sirdani O.F.M. nuk bën tjetër veç përforcon një kuadër në të cilin epërsinë vijon ta mbajë heroi ynë me vetitë e tij që konvergojnë natyrshëm në një person të vetëm. Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut është e lidhur pandashëm me personazhe që herë përkras të tij, herë ndjekës të interesave të ngushta personale lanë gjurmë dhe ndikuan dhe në rrjedhën që do të merrte marrëdhënia mes fisnikëve dhe të parëve të krahinave të vendit. Janë po aq për t'u shënuar figura që përfaqësojnë personazhe komplekse, në sa mund të jenë me origjinë shqiptare, por të mbujtur e të rritur në vende të huaja e duke u vënë në shërbim të turqve, janë në të vërtetë armiqtë më të egër për Skënderbeun dhe për ushtrinë e tij. Në këtë këndvështrim, figura e Lekë Dukagjinit, krenar dhe kryelartë për çka mendonte se i përkiste, mbetet po aq e trajtuar në shënimet dhe shkrimet e at Marin Sirdanit O.F.M., dhe kompleksiteti i tij karakterial do të krijojë jo pak vështirësi për ecurinë e ngjarjeve në të cilat Gjergj Kastrioti ishte i thirrur drejtpërdrejt të luante rolin e tij prej prijësi.<sup>6</sup>

Ribotimi i kontributeve kryesore të këtij prelati vitet e fundit përbën një gjest domethënës dhe krejt me vend sa i takon çështjes së rikthimit të vëmendjes ndaj monumenteve shkrimore që i bëjnë nder historiografisë shqiptare dhe lartësimit të figurave themelore të saj. Ribotimi anastatik i veprës me të cilin Marin Sirdani u bë i njohur në dekadat e para të

<sup>5</sup> Marin Sirdani O.F.M., "Në shka fajiset Skanderbegu", në *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Shkodër: Botime Françeskane, 2017, f. 42 (botuar së pari në *Hyllin e Dritës*, n.2, 1935; n.3, 1935; n.11, 1935; n.1, 1936; n.2, 1936; n.3, 1936).

<sup>6</sup> Marin Sirdani O.F.M., "Një rival i Skanderbegut", botuar në *Hyllin e Dritës*, n.7-8, 1932, f.385-395; pasqyruar në *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017, f.43-65.

shekullit të kaluar, *Skanderbegu mbas gojëdhënash*<sup>7</sup>; si dhe përfshirja e kontributeve më specifike të tij në lidhje me historinë e Skënderbeut në përmbledhjen më të fundit me titull *Gjergj Kastrioti- Atleta Christi*<sup>8</sup>, janë një tjetër dëshmi e një vlerësimi të tillë.

## BIBLIOGRAFI

- BARDHI, F. - *Skënderbeu (Apologji)*, përktheu nga latinishtja Stefan I.Prifti, Tiranë: 1967.
- BARLETI, M. - *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga S.J.Prifti, Tiranë: 1964.
- BARLETI, M. - *Historia e Skënderbeut*, botim i tretë, përkthyer nga S.I. Prifti, Tiranë: Naim Frashëri, 1982.
- BARLETI, M. - *Historia e Skënderbeut*, Libri XI, Botimi IV, shqipëroi Stefan Prifti, Tiranë: Infbotues, 2005.
- BARLETI, M. - *Rrethimi i Shkodrës*, përkthyer prej origjinalit latinisht nga H.Lacaj, Botimi i dytë i plotësuar, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1967.
- BARLETI, M. - *Rrethimi i Shkodrës*, përktheu H.Lacaj, përgatiti për botim D.Hosaflook, Tiranë: Botime Onufri, 2012.
- CEKA, H. - *Vërejtje mbi disa të dhana topografike rreth luftave të Skënderbeut sipas Barletit*, Buletin për Shkencat Shoqërore, Instituti i Shkencave, Tiranë: 1952.
- KAMSI, W. - “Rrethimi i parë i Shkodrës (1474)”, në *Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës*, nr.7, Shkodër: 1968.
- MARLEKAJ, L. - *Scanderbeg nelle tradizioni popolari albanesi*, Bari: 1969.
- NADIN, L. - *Migrazioni e integrazione: il caso degli Albanesi a Venezia (1479-1552)*, Romë: Bulzoni editore, 2008.
- NADIN L. - *Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto*, përktheu Pëllumb Xhufi, Tiranë: Onufri, 2012.
- NADIN, L. - “Religiosi albanesi nelle terre della Serenissima tra Quattrocento e Cinquecento: uno scenario di incredibile ampiezza, tra storia di chiese e storie di arte”, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2013.

<sup>7</sup> *Skanderbegu mbas gojëdhënash*, Shkodër: 2008; botimi tematik me titull: *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Shkodër: Botime Françeskane, 2017.

<sup>8</sup> *Gjergj Kastrioti - Atleta Christi*, Shkodër: Botime Françeskane, 2018.

- NADIN, L. - "Marino Barlezio tra Venezia, Padova, Vicenza. Paesaggi veneto-scutarini", në *Shêjzat-Pleiades*, n.1-2, 2016.
- PALL, F. - *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucaresti: 1938.
- PLASARI, A. - *Skënderbeu, një histori politike*, Instituti i Studimeve Shqiptare" Gjergj Fishta", Tiranë: 2010.
- PLASARI, A. - *Shqipëria dhe shqiptarët në Europën e Piut II*, Tiranë: IDK, 2014.
- PETROTTA, G. - *Popolo, lingua e letteratura albanese (a cura di M.Mandalà)*, Palermo: Edizioni Mirror, 2003.
- ROQUES, M. - *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris: 1932.
- SIRDANI M. O.F.M. – "Skanderbegu mbas gojdhânash", në *Zâni i Shna Ndout*, n.III, 1920.
- SIRDANI M. O.F.M. – "Kerkime mbî vorrin e Skanderbegut", në *Hylli i Dritës*, n.4, 1932.
- SIRDANI M.O.F.M.c – "Nji rival i Skanderbegut", në *Hylli i Dritës*, n.7-8, 1932.
- SIRDANI M. O.F.M. - *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Shkodër: Botime Françeskane, 2017.
- ZAMPUTI, I. – "Lezhja, Rodoni, Durrësi dhe përpjekjet e fundit për rimëkambjen e principatave shqiptare", në *Studime historike*, n.1, Tiranë: 1964.
- ZAMPUTI, I. – "Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase për historinë e Shqipërisë për tre shekujt e parë të pushtimit turk", në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, n.3, Tiranë: 1955.
- ZAMPUTI, I. – "Shënime mbi disa aspekte të lëvizjes çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk", në *Studime historike*, n.1, Tiranë: 1965.
- ZAMPUTI, I. – "Elemente të vetëdijes shqiptare në përpjekjet për liri, për gjuhën shqipe e për arsim në shekujt XVI-XVII", në *Studime historike*, n.3, Tiranë: 1965.